REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 287/19
Datë/Datum. 07.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit:**AQP/18/014/111UA/2016-18-3787-1-1-1**

Sa i përket tenderit për:**Furnizim me Peme dhe Perime**

Kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës: 24.05.2019

Për Anulim te procedurës se Prokurimit

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KonsorciumiAlfa Group SHPK &FadiComSHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

PRISHTINE
(Adresa)
PRISHTINE
(Vendi)(Kodi postar)

+383 45 306 008
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

ALBAN MEHMETI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Alfashpk2013@gmail.com
(Adresa elektronike)

07.06.2019
(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

ALFA GROUP

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Aktiviteti i prokurimit është publikuar me datën: ***17.12.2018*** *Pranimi/dorëzimi i ofertave me date:* **10.01.2019**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Procesi i hapjes ka qene ne pajtim me dispozitat LPP-se.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

Nga AQP me dt: 24.05.2019 përmes e-prokurimit jemi njoftuar me letër standarde te tenderuesit te eliminuar.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Autoriteti Kontraktues-AQP me datën: **24.05.2019** ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku ka rekomanduar anulimin e procedurës se prokurimit ne mungese te ofertave te përgjegjshme.

Konzorciumi **Alfa Group SHPK & Fadi Com shpk** me datën: **28.05.2019** ne pajtim me Nenin 108/A te LPP-e kemi paraqit kërkese për rishqyrtim përmes e-prokurimit duke kërkuar nga AK-AQP te anuloj njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dt 24.05.2019 duke kthyer procesin ne Rivlerësim pasi qe oferta jone i ka plotësuar ne tërësi te gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit.

AK-AQP me datën: **30.05.2019** ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si te pabazuar me arsyetimin se anëtari i konzorciumit nuk i ka plotësuar kërkesat e neni 65 te LPP-se por nuk ka ofruar asnjë sqarim për deklaratat e konzorciumit te cilat kane qene pjese te ofertës dhe për te cilat ka eliminuar ofertën tone duke ju referuar letrës standarde te tenderuesit te eliminuar.

SQARIM- Zyra e prokurimit nuk ka ofruar asnjë përgjigje për arsyet e eliminimit te cilat i ka dërguar me dt.24.05.2019 qe mungojnë deklaratat e konzorciumit përkatësisht autorizimi i liderit, por ka cekur tani arsye tjera te eliminimit për anëtarin e konzorciumit.

Dëshmitë:
Njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues te datës; 24.05.2019 nga e-prokurimi.
Letra standarde tenderuesit te eliminuar dt:24.05.2019.
Kërkesa për rishqyrtim te datës: 28.05.2019 nga e-prokurimi.
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te datës: 30.05.2019 nga e-prokurimi.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AQP ka bere shkelje te Ligjit 04/L-042 te LPP-se I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

- ***Neni 7*** Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
- ***Neni 59*** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
- **Neni 56 Paragrafi 3** Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave.
- **Neni 65** Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- **Neni 71** Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ankesa ne OSHP paraqitet për pretendimin e njëjte ankimor për te cilin jemi eliminuar nga procedura e prokurimit. Paraqesim pretendimin e njëjte ankimor sipas letrës standarde te eliminimit te datës: 24.05.2019. Pretendimi ankimor është ne pajtim me Nenin 9 paragrafi 2 "***Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues***" *te Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.*

Kërkesa për rishqyrtim Afatshme

Kërkesa për rishqyrtim është ne kuadër te afati ligjor sepse ne rastet kur letrat standardë dhe vendimi mbi njoftimin te AK ngritët ditën e Premte atëherë afati ec nga kjo dite dhe përfundon ditën e marte, dhe ne ketë rast afati i fundit është sot ne ora 16:00.

Konzorciumi **Alfa Group SHPK & Fadi Com** ne pajtim me Nenin 108/A te LPP-se paragrafi 3 pika 3 paraqet kërkese për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoriteti kontraktues te datës: 24.05.2019 për ANULIMIN procedurës se prokurimit ne mungese te 3 ofertave te përgjegjshme.

Letrat standarde dhe njoftimit mbi vendimin Autoritetit kontraktues datës: 24.05.2019

Autoriteti Kontraktues-AQP me datën:24.05.2019 ne e-prokurim ka ngrit letrat standarde dhe njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues për anulimin e procedurës se prokurimit. Ne letrën standardë te eliminimit te konsorciumit ka cek ketë arsye:

X Nuk jeni të përgjegjshëm në aspektin administrativ nuk keni plotësuar Autorizimin për Liderin komfor LPP-së

Konsorciumi nuk pajtohet me ketë vlerësim dhe ekzaminim te AK-AQP sepse:

Pjese te ofertës kemi ofruar te plotësuar dhe nënshkruar Aneksin 6 te dosjes se tenderit "***Deklaratën për themelimin e grupit***" ku ne piken e trete te kësaj deklarate palët deklarojnë se autorizojnë liderin ***Alfa Group SHPK*** me person te autorizuar Alban Mehmeti për te vepruar ne emër te grupit. Për me shume referojuni tekstit te deklaratës si ne vijim:

Hyjne ne bashkëpunim / konzorcium , për qëllim të këtij tenderi me titull: "Kontrate kornize për furnizim me pemë dhe perime" me numer te prokurimit AQP/18/014/111. Palet konfirmojne se:

- palet deklarojne qartë se si anëtarë te grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për permbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës
- palet konfirmojne se marrin pjese ne këtë grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjese ne ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- palët me këtë deklarate autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, i cili është;

Emri i Operatorit Ekonomik (lider) ***ALFA GROUP SHPK***

Emri Mbiemri (Perfaqesuesi i autorizuar) **ALBAN MEHMETI**

Data/Nenshkrimi / Vula 10.01.2019

Dëshmi: ***Deklarata për themelimin e grupit/plotësuar dhe nënshkruar siç është kërkuar ne DT.***

Çdo dokument apo deklarate tjetër lidhur me AUTORIZMIN E LIDERIT ne ofertën tone është i relevantë e parëndësishme sepse dokument bazik për konsorciumin dhe autorizimin e liderit është Aneksi 6 DT i cili dokument është i nënshkruar dhe plotësuar siç është kërkuar. Pra çdo dokument tjetër për mënyrën e autorizimit janë devijime vogla siç e përcaktojnë dispozitat e LPP-se.

Duke ju referuar dispozitave te LPP-se Nenit 71 dhe 27 te UOPP Grupi i Operatoreve ekonomik janë te obliguar te ofrojnë 3 deklarata ku ne piken C specifikohet se përmes deklaratës se nënshkruar anëtaret e konsorciumit autorizojnë liderin te veproj ne emër te grupi për me shume shih pike C si ne vijim:

a. ***Dorëzon një deklaratë të qartë*** *që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;*
b. ***Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët***, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar);
c. ***Një deklaratë e nënshkruar*** nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar; dhe

Ne dosjen e tenderit dhe njoftim për kontrate nuk është kërkuar asnjë lloj autorizimi tjetër qe duhet te ceket se grupi i operatoreve ekonomik/palët duhet te ofrojnë një autorizim te veçante për liderin e grupit. Konsoricumi ka vepruar ne pajtim me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë respektivisht ka ofruar te plotësuar dhe nënshkruar:

- ***Deklaratën për themelimin e grupit ku ne piken 3 është autorizuar lideri Alfa Group SHPK me person te autorizuar Alban Mehmeti sipas kërkesave ligjore te Nenit 71 te LPP-se dhe 27 te UOPP.***
- ***Deklaratat nen betim ne pajtim me Nenin 65 te LPP-se.***

Sipas dispozitave te LPP-se këto janë te vetmet kërkesa ligjore qe operatoret ekonomik ne rast ofertimi si konsorcium duhet ti plotësojnë dhe asnjë kërkese tjetër.

Shkelje te Dispozitave Ligjore te LPP-se

Konsorciumi nuk ka ofruar asnjë lloj autorizimi tjetër për liderin sepse nuk ka qene një kërkese e tille e specifikuar ne njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit, andaj kjo arsye e eliminimit tuaj është ne kundërshtim me Nenin 56 paragrafi 3 te LPP-se "***Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".***

Për shkak se arsyeja juaj e eliminimi te ofertës nuk ka qene pjese te dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë, vlerësojmë se AK-AQP ka bere shkelje te Nenin 7 duke diskriminuar pa te drejte ofertën tone për ketë aktivitet te prokurimit dhe Nenit 59 pasi qe nuk keni vlerësuar dhe ekzaminuar ofertën tone ne pajtim me kërkesat dhe kriteret e dosjes se tenderit por keni vlerësuar jashtë kërkesave te DT. Kjo bie kundërshtim me paragrafin 4 te këtij Neni "***Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".***

Vendimi i AK-AQP-se datës: 30.05.2019

AK-AQP ne vendimin e refuzimit te kërkesës për rishqyrtim si te pabazuar nuk ka paraqit asnjë argument apo prove kundërshtuese lidhur mbi arsyen e eliminimi te ofertës sonë ne mungese te autorizimit te liderit nga anëtari i grupit. Pra asnjë prove qe dëshmon se ne oferte ka munguar deklarata e themelimit te grupit te OE. Pra konzorciumi ka ofruar te plotësuar dhe nënshkruar Aneksin 6 te DT siç e keni kërkuar.

Lidhur me arsyen tjetër te cekur ne vendim se anëtari i konzorciumit FADI COM SHPK nuk i ka plotësuar kërkesat e Nenit 65 te LPP-se, ne si lider nuk mund te mbajmë përgjegjësi ligjore për dokumentet qe ofron një anëtari i grupit te operatoreve ekonomik.

Deklaratat e Anetarit te konzorciumit/Fadi Com shpk

Anëtari i konzorciumit konsideron se çështja ne fjale është një gabim teknik ne sistem te ATK-se, për me shume referojuni deklaratës zyrtare te **Fadi Com shpk** te dt: 06.06.2019 dhe deklaratës Z.Nazim Berisha te datës: 05.06.2019 i autorizuar për nxjerrjen e vërtetimit tatimor te datës: 08.02.2019 me numër serik:1000551838. Kërkojmë nga Eksperti shqyrtues dhe Paneli i OSHP-se qe deklaratat ne fjale te merre ne shqyrtim dhe ekzaminim ne seancën për shqyrtimin kryesor.
Dëshmi: ***Deklaratat nga anëtari i konzorciumit.***

Vërtetimi i Ri Tatimor

Ju njoftojmë se anëtari i konzorciumit ***Fadi Com SHPK*** pas këtij vërtetimi tatimor me gabim teknik referuar deklaratave, ka nxjerr vërtetimin e ri tatimor dt: 08.05.2019 numër serik:1000586645 qe ka me marrëveshje për shlyerje te borgjeve ndaj ATK-se te cilën ja kemi dërguar dhe AQP-se me te njëjtën dite. Ky vërtetim përmbush kërkesën ligjore te nenit 65 te LPP-se dhe njeherit bene konzorciumin te përgjegjshëm për ketë aktivitet te prokurimit.

AQP-ja për shkak mos vlerësimit dhe ekzaminimit te vërtetimit te ri tatimor i cili ka plotësuar kërkesën ligjore ka bere shkelje ligjore te Nenit 65 te LPP-se pasi qe vërtetimi është ne marrëveshje për shlyerje te borgjeve ndaj ATK-se.

KERKOJM

Nga Paneli Shqyrtues pranë OSHP-se:

Te **APROVOHET**- Ankesa ne tërësi **si e BAZUAR.**

Te **ANULOHET**- Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës:**24.05.2019** dhe procedura e prokurimit te kthehet ne **RIVLERESIM sipas dispozitave te LPP-se.**

Me respekt

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Shpenzimet administrative për përgatitjen e tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*